



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit, mbajtur më 10.03.2020, e cila filloj në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Adrian Berisha (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Valbona Petrovci (e pavarur), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Eman Rahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Ylli Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fikneta Bejta (e pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (i pavarur) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Migjen Shala (PDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK) dhe Naime Osmani (LDK), Visare Gashi (PSD).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkyretar i Komunës, Gëzim Mehmeti, drejtës i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Ardian Olluri, drejtës i Drejtorisë së Urbanizmit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Genc Bashota, drejtës i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Dren Kukaj, drejtës i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Fitim Rexha, drejtës i Drejtorisë së Sportit, Shkumbin Gashi, drejtës i Drejtorisë së Bujqësisë, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoj Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit.

Faqe 1 nga 11

Para se të fillonin me diskutimet për rendin e ditës, kryesuesi i ftoi anëtarët e rinj të Kuvendit, nga radhët e subjektit politik LVV, për të bërë betimin para Kuvendit, znj. Nazlije Bala, në vend të znj. Vjosa Hamiti - Krasniqi, dhe Naim Hoxha, në vend të z. Eman Rrahmani.

**Osman Bllaca** propozoi që të shtohet një pikë e rendit të ditës: "Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Komitet për Politikë dhe Financa nga subjekti politik i LVV-së, në vend të z. Eman Rrahmani.

**Dren Kukaj**, drejtor, i njoftoi të pranishmit rreth pranimit të një donacioni nga Norvegjia, për pajisje të ndryshme për personat me aftësi të kufizuara. Lidhur me këtë, kërkoi nga Kuvendi që të ndahet shuma e mjeteve prej 5200 euro për mbulimin e shpenzimet të transportit.

**Egzon Azemi**, propozoi që në rend të ditës të futet për diskutim dhe miratim projektit për ndarjen e mjeteve, nga 150 euro për fëmijët e porsalindur.

**Suzan Kika** tha se do të ishte një ide e mirë që ne si Komunë, të ndërtojmë një linjë buxhetore për çdo lindje, që lehonat dhe fëmijët të përfitojnë një ndihmë financiare në vlerë prej 150 euro.

Ajo kërkoi që kjo temë të futet në rend të ditës për diskutim.

**Shpend Ahmeti**, kryetar, tha se nëse këto propozime bëhen sot temë diskutimi, kisha propozuar që të zotohet ekzekutivi, që të fillojë iniciativën për ta bërë një analizë më të saktë të numrit të lindjeve në komunën e Prishtinës, pastaj i caktojmë edhe kriteret e ndryshme që duhet të bëhen për të bërë pagesa të tilla. Në çoftë se aprovohet përmbledhjen e radhës së Kuvendit, atëherë të sjellim një analizë, pastaj të vendosim edhe përkohën e saktë se kur mund të fillojmë.

**Shefki Gashi** theksoi se çështja që u propozua e shoh si një problem kombëtar, andaj kjo kërkon një qasje më serioze, më të qëndrueshme, por duke shkuar gjithnjë me një analizë, pastaj me ardhur me një përfundim që mund të realizohet.

**Hafiz Krasniqi** e përkrahu iniciativën e propozuar dhe kërkoi nga të gjithë, së bashku me grupet parlamentare, që ta formojnë një komision lidhur me këtë, në mënyrë që përmbledhjen e ardhshme të Kuvendit, të vijmë me të gjitha kriteret edhe për shumën dhe për destinimin e mjeteve, edhe për të gjitha format për të cilat e bëjnë një vendim ashtu si duhet të merret.

**Nol Nushi** shprehu mendimin se këtij propozimi duhet t'i bëhet një analizë më konkrete, pasi që këtu po na paraqiten disa propozime për shumën e mjeteve financiare rreth subvencionimit, andaj kërkoi që mos të krijohen situata të pavolitshme. Do të ishte mirë që të parashihen forma të tjera, të cilat janë forma të zbutjeve të shpenzimeve. Këto janë gjëra më komplekse sesa një propozim i padiskutuar, i pa analizuar. Kjo nuk do të thotë që propozimi është i keq, por duhet bërë edhe analizë të saktë edhe mos me gabuar gjatë rrugës.

**Agim Gashi** u shpreh se nuk jam kundër idesë që të përkrahen lehonat, përkatësisht fëmijët e porsalindur, sepse është një punë që i përfshinë kategoritë, të cilët vijnë në këtë botë dhe nuk kanë kushte elementare, por është edhe ironia tjetër, se një pjesë e madhe e popullsisë nuk ka nevojë për atë buxhet, për arsy se qëndron mirë ekonomikisht. Ne këtu nuk jemi për të dhënë ide të pa analizuara, por jemi për të qenë shumë racional për çdo gjë. Pra, duhet t'i kemi parasysh që mos t'i harrojmë edhe

fushat tjera, ku Komuna sot përballet me probleme që nuk i kanë shkaktuar komunat, por i ka shkaktuar niveli qendror.

**Fiknete Bejta** propozoi që sot të mos merret vendim, vetëm të jepet një rekomandim për Komunën, për ekzekutivin, që të analizojë këtë propozim të asamblistëve. Edhe pse ky propozim ka ardhur në bazë të një diskutimi që e kemi pasur ne gratë asambliste një javë më parë, mirëpo nuk është i trajtuar mirë dhe nuk ka një analizë të mjaftueshme. **Leutrim Retkoceri**, sa i përket këmbimit të pronave, tha se do të ishte mirë që këmbimi të shkojë në bazë të listës, jo disa qytetarë të presin me vite të tëra, e disa me u futur për këmbim prone brenda ditës. Po ashtu, propozimet e tillë për këmbimin e pronave nuk janë të sinqerta, përderisa drejtori i Drejtorisë së Pronës asnjëherë nuk ka prezantuar në mbledhje.

Gjithashtu, në seancën e parë ka ardhur një propozim për veprimtaritë afariste, janë bërë diskutime, propozime, në atë diskutim ku nuk ka qenë vetë propozuesi i kësaj ideje, dhe përderisa ka ide dhe propozime edhe ato nuk trajtohen në formë institucionale, traumatizohet opinioni publik me propozime të tillë që dalin nëpër medie se Prishtina të dielën nuk punon.

**Sshpend Ahmeti**, kryetar, tha se procedurat për këmbimin e pronave janë të specifikuara në Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës dhe këmbim të pronave komunale, pra janë të specifikuara mirë se kur mund të bëhet këmbimi i pronës, çoftë me iniciativë të qytetarit, çoftë me iniciativë të Komunës.

**Nazlije Bala** kërkoi nga të pranishmit që për pikën e cila u propozua, të jemi serioz dhe të përgjegjshëm për kategorinë më të marginalizuar në shoqëri, pra për nënët që janë të papuna, për nëna të cilat nuk kanë mundësi për rritjen, ngritjen dhe mirëqenien e fëmijëve, për nëna ndaj të cilave shteti dhe komuna ka obligime.

**Dren Kukaj**, drejtor, tha se para dy vjetëve ka filluar një iniciative për themelin e një grandi specifik për mirëqenie sociale për komunat në nivel të Kosovës. Nuk e di si ka ngelur kjo çështje, mirëpo duhet ta kemi parasysh që kur flasim për këto kompetenca, janë kompetenca që i kemi marrë prej Qeverisë, mirëpo asnjëherë ne nuk i kemi marr mjetet e punës. Ne operojmë në Komunën e Prishtinës me 18 punëtorë socialë, dhe mbi 2000 raste në vit i trajtojnë këta punëtorë socialë, që është jashtë çdo standardi!

Sa i përket këtij propozimi, mendoj qe është i ngutshëm dhe i paanalizuar, dhe nuk i plotëson nevojat që janë reale në qytet.

**Vala Peshku** u shpreh se do dëshiroja që të jemi pak më serioz kur diskutojmë tema të ndjeshme. Këtu vërehet një paqartësi, a po kërkojmë me i shpërblyer fëmijët e porsalindur, apo nënët që kanë me lindur, apo vetëm lehonat. Pra, mund të them se termet që jeni duke i përdorur, janë secila më larg se tjetra.

**Kryesuesi** kërkoi nga të pranishmit, që fokusi i diskutimit të përqendrohet vetëm në propozim e dhënë nga Egzon Azemi dhe Suzan Kika.

**Drilon Pireva** tha se kjo çështje u shpjegua qartë nga drejtoi i Drejtorisë së Pronës, i cili tha se ka shumë grupe të tjera të marginalizuara që kurrë nuk i kemi diskutuar. Ka edhe çështje të tjera, e që kryesisht janë çështje nationale, kryesisht janë probleme të Qeverisë së Kosovës, andaj ne duhet me i diskutuar edhe në parim duhet me i mbështetë të gjitha iniciativat, por duhet pasur shumë kujdes që mos të bëjmë punë veç sa për konsum publik.

Suzan Kika propozoi që të behet një analizë buxhetore dhe të futet në rend të ditës propozimi i dhënë.

Egzon Azemi theksoi se, duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, në bazë të nenit 17 dhe pikave të tjera, propozojmë shtimin e një kategorie buxhetore për mbështetjen e nënave lehone dhe fëmijëve të porsalindur.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e dhënë.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për, 9 kundër dhe 9 abstenime, u miratua propozimi që të futet në rend dite për diskutim: *"Propozimvendimi për mbështetjen financiare nënave lehone dhe fëmijëve të porsalindur."*

Me propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua ky

#### Rendi i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit dhe "Alt Trade Holding LS";
3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Sali Grajqevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemit dhe Alban Becit;
4. Propozimvednimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Tafil (Arif) Osmanit;
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës, 2020-2022;
6. Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme, 2020-2022;
7. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
8. Propozimvendimi për miratimin e ndarjes së subvencionit për transportimin e donacionit në mallra për personat me aftësi të kufizuara;
9. Diskutim për Raportin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
10. Diskutim për Raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;
11. Pyetje dhe përgjigje.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

**Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për, 1 kundër dhe 3 abstenime, u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së parë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

**Pika e dytë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit dhe "Alt Trade Holding LS".**

**Halim Halimi** tha se është më se e nevojshme që këmbimi i pronave të shqyrtohet edhe në Komitetin për Pronë, por deri tash asnjë nga këto pika nuk janë shqyrtuar në këtë komitet dhe këto pika na sillen të papërgatitura në KPF dhe në Kuvend. Mendoj se për këmbimin e këtyre pronave nuk përfillen procedurat e listave të renditura të palëve, por bëhen këmbimet varësisht prej fuqisë së personave privatë që kanë këmbim, ose anasjelltas. Po ashtu, edhe drejtori i Pronës nuk prezanton në mbledhje dhe nuk e sheh të arsyeshme me na dhënë sqarime lidhur me këto këmbime të pronave.

**Shefki Gashi** tha se ka qenë një ide edhe një qëndrim si Kuvend, që mos me bërë ndarje, por me iu qasur të gjitha lëndëve, që të gjithë qytetarët me i trajtuar me radhë dhe në mënyrë të barabartë, sepse është një numër i madh i qytetarëve që presin për këto lëndë dhe nuk sillen në Kuvend për këmbim.

**Agim Gashi** ceku se ky standard qe është vënë dhe po aplikohet te ne sa i përket këmbimit të pronave, nuk i përbush nevojat në kuptimin e transparencës, për arsyen se është vështirë që të kuptohet gjuha kadastrale. Do të ishte mirë që në pjesën e arsyetimit të propozimvendimit, ose me prezencën e personit të autorizuar të drejtorisë përkatëse, të na jepen sqarime praktike, për ta kuptuar të gjithë se ku merret kjo pronë dhe ku jepet prona tjeter.

Të gjithë jemi për me i ndihmuar këto procese, sepse nuk përbushen detyrat dhe obligimet e Komunës karshi zhvillimit të Komunës së Prishtinës bazuar në rregullativën urbanistike, por po na krijoni dilema të paqena, të cilat pa nevojë po i shtrojmë këtu. Në mungesë të informatave elementare, unë personalisht nuk e votoj këtë propozimvendim për këmbim të pronës.

**Adrian Berisha** tha se unë nuk do ta votojë asnjë pikë, përderisa drejtori i Drejtorisë së Pronës nuk është i pranishëm që të na shpjegojë më hollësishët të gjitha këto pika.

**Vala Peshku** propozoi që, nga mbledhja e radhës, për të gjitha ato pika të cilat diskutohen, domosdø duhet të jenë prezantë edhe drejtorët e drejtorive përkatëse. Për mos prezencën e tyre, pikat që sillen nga ato drejtori ne nuk do t'i votojmë.

**Fadil Gashi** tha se unë do t'i votoj të gjitha këto propozimvendime për miratim.

**Leonora Shabani - Bajraktari** theksoi se asnjë pikë të rendit të ditës sa i përket pronave dhe parcelave për këmbim, nuk do t'i votoj, për arsyen se drejtori i Drejtorisë së Pronës asnjëherë nuk ka marrë pjesë në këto takime.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se, nëse është qëndrim i vullnetit të shumicës së anëtareve të Kuvendit, këto pika mund të largohen nga rendi i ditës, që mos të dalim në lajthtitje deri në ardhjen e drejtorit për të na sqaruar lidhur me këto këmbime.

Njëherësh, duhet ta kemi një listë të qytetarëve që janë në pritje për këmbim të pronës.

**Ardian Olluri**, drejtor, tha se sipas Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës, Kryetari e propozon këmbimin dhe Kuvendi e miraton.

Në mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Pronës, Kryetari më ka autorizuar me i dhënë përgjigjet për çdo dilemë që ju e keni për pikat që janë në diskutim.

Këto prona të cilat po këmbehen, po i shfrytëzojmë për interesin publik. Po ashtu, këmbimet po na mundësojnë me i realizuar planet zhvillimore që i kemi miratuar dhe nëse nuk i bëjmë këmbimet, nuk mund t'i realizojmë këto plane. Andaj, është shumë me rëndësi që sot të votohen këto propozim vendime, në mënyrë që këta ndërtimtarë që janë duke pritur, të mos presin edhe një muaj deri në mbledhjen e ardhshme. Valbona Ajeti kërkoi nga kryesuesi që të procedohet me këtë pikë të rendit të ditës dhe të qitet në votim për miratim.

Mirsad Vitia tha se sa i përket pronave dhe parcelave për këmbim të Komunës së Prishtinës, ne i kundërshtojmë dhe nuk do t'i votojmë këto pika të rendit të ditës. Prezenca e drejtorit të Drejtorisë së Pronës në mbledhje do të ishte më se e domosdoshme, për të na dhënë sqarime për rëndësinë e këtyre pikave të rendit te ditës.

*Kryesuesi propozoi që të votohen për miratim këto pika, që mos të dëmtohen qytetarët, por bëri me dije që mesazhi të jetë i qartë, që nga mbledhja e ardhshme, nëse drejtori i Drejtorisë së Pronës nuk do të jetë i pranishëm në mbledhje, nuk do të votohet asnjë pikë që ka të bëjë me këmbimin e pronave.*

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për, 19 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit dhe "Alt Trade Holding LS".

#### Pika e tretë

Propozim vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Sali Grajqevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemit dhe Alban Becit.

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 16 kundër dhe 7 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Sali Grajqevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemit dhe Alban Becit.

#### Pika e katërt

Propozim vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Tafil (Arif) Osmanit.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 13 kundër dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi te Tafil (Arif) Osmanit.

#### Pika e pestë

Propozim vendimi për miratimin e Planit komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës, 2020-2022.

Egzon Azemi kërkoi të dijë arsyen , se pse në këtë plan specifikohen si vende të kthimit vetëm tri shtete, që janë Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi. Do të ishte mirë që të na jepej një informatë lidhur me këtë çështje. Ne parimisht do ta mbështesim, edhe jemi për me votuar këtë plan, por asnjëherë nuk duhet të harrojmë qe kjo politikë po votohet për komitetet minoritare, e krejt e kundërtat ndodh nëpër komunat jo shumë larg Prishtinës ku shumica e banoreve janë shqiptarë. Kur ne tash po e votojmë këtë plan për kthimin e serbëve në Kosovë, po zhvendosen e po hiqen nga lista shqiptarët vetëm për arsyen se janë shqiptarë!

**Lulzim Vrapca**, udhëheqës i Zyrës për komunitete dhe kthim, tha se në Planin komunal për personat e zhvendosur në periudhën 2020-2022, përfshihen vetëm personat e zhvendosur nga Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, pra në periudhën 28 shkurt të vitit 1998, deri më 24 mars të viti 2004. Kjo rrjedh nga Strategjia për kthimin e personave të zhvendosur, ku janë të specifikuara ata të cilët kanë pasur konflikte, p.sh. lidhur me pronën, me komshiun, dhe si rrjedhojë e kësaj është larguar nga Kosova. Përmes këtij plani do të parashihet integrimi i tyre në shoqërinë kosovare.

Arbenita Murseli u shpreh në përkrahje të miratimit të këtij plani për ri integrimin e personave të riatdhesuar dhe ndihmës së këtyre persona, të cilët nuk janë larguar nga dëshira. Si institucione lokale, por edhe qendrore, është koha që t'i përkrahim, t'u dalim në ndihmë, si në banim, strehim, shkollim, punësim etj.

**Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 3 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Plani komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës, 2020-2022.**

#### Pika e gjashtë

**Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme, 2020-2022.**

**Kryesuesi konstatoi se me më 35 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme, 2020-2022.**

#### Pika e shtatë

**Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

**Osman Bllaca** i njoftoi të pranishmit se në vend të Hateme Gashit, përfaqësuese nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, emërohet Edona Krasniqi, zyrtare nga Sektori i Kuvendit. Po ashtu, Nysret Beka, përfaqësues i KLSP-së, për siguri publike në lagjet "Arberia" e "Tophane", nga Stacioni policor "Qendra" caktohet anëtar i ri i KKSB-së.

**Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 2 kundër dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për miratimin e ndarjes së subvencionit për transportimin e donacionit me mallra për personat me aftësi të kufizuara.**

**Kryesuesi konstataoi se më 35 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e ndarjes së subvencionit për transportimin e donacionit me mallra për personat me aftësi te kufizuara.**

**Pika e nëntë**

**Diskutim për Raportin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

**Kryesuesi konstataoi se më 32 vota për dhe 4 abstenime, u miratua Raporti vjetor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

**Pika e dhjetë**

**Diskutim për Raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019.**

Vala Peshku bëri vërejtje rrith votimit të raporteve, duke thënë se edhe më herët kam bërë vërejtje lidhur me votimin e këtyre raporteve, këto duhet vetëm të diskutohen, pa pasur nevojë të votohen.

**Leutrim Retkoceri** tha se Komiteti për Komunitete, si komitet obligues, është mirë që të raportojë për punën që ka bërë.

Lidhur me raportet, tha se kryesuesi i Kuvendit duhet të kërkojë raporte prej atyre komiteteve që janë të formuara, por që nuk janë aspak funksionale, dhe të shihet se a janë duke funksionuar apo jo, kështu që shumë tema me rëndësi në komunën tonë kishin mundur të diskutohen në komitet përkatëse.

Po ashtu, kërkoi që në mbledhjen e radhës së Kuvendit të sillen raportimet e ndërmarrjeve publike dhe të bëhet diskutimi për ato raporte, për secilën veç e veç, në seancat e caktuara, ashtu siç e parasheh Plani i punës së Kuvendit.

**Agim Gashi** bëri vërejtje rrith prezantimin të këtyre dy raporteve, duke thënë se këto raporte të punës që i kemi të atyre dy instrumenteve komunale, siç është ai i Komitetit për Komunitete dhe i KKSB-së, aty janë të dhënët e ofruara, të shkruara në mënyrë shkarravitëse, dhe nuk iu ngjajnë dokumenteve zyrtare që vijnë në Kuvend, ku njerëzit me përgjegjësi i ngrenë gishtërinjtë për votim, andaj kërkoj që raporte të tilla të mos na prezantohen në të ardhmen.

**Kryesuesi konstataoi se në mungesë të kuoromit, kjo pikë e rendit të ditës nuk mund të hedhet në votim.**

**Pika e njëmbëdhjetë**  
**Pyetje dhe përgjigje.**

**Kushtrim Sopa, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm:**

1. Banorët afër rrugës "Hyzri Talla" në lagjen "Kodra e Diellit", paraqesin dy shqetësimë:
  - Shqetësim i kahershëm me prezencën e qenve endacakë, saktësisht te banesa e Rexhep Selimit, një grumbull qensh që sulmojnë qytetarët në vazhdimësi, gjë që për këtë rrezik qytetarët janë detyruar të njoftojnë edhe policinë;
  - Ka më se katër javë që ndriçimi i kësaj rruge nuk është funksional, dhe nuk dihet se ku është problemi.
2. Qytetarët ( afaristët ), te Çarshia e Vjetër, janë shumë të shqetësuar për projektin "Tregu i Ri", lidhur me fatin e mbi 80 bizneseve. Qytetarët kanë bërë kërkesë edhe te Kryetari i Komunës për takim, por nuk është marrë parasysh kërkesa e tyre, andaj dhe konsiderojnë që projekti është kontrabanduar nga udhëheqja e Komunës, sepse nuk ka transparencë fare, pasi që nuk ka pasur diskutim publik. Këta qytetarë zejen e tyre e ushtrojnë tash e 50 vjet në lokalet aktuale (përkatëse), sipas tyre nuk ka shkuar askush t'i pyes dhe të diskutojë me ta asgjë lidhur me projektin. Sipas qytetarëve (afaristëve), në vitin 2016 ka qenë një diskutim në objektin e ri të Komunës, por ishte fjala për një projekt më të vogël dhe për projekt me partneritet publiko-privat. Që nga ajo kohë e deri tash, është ndryshuar projekti dhe tash është projekt shumë më i madh në kuptimin e investimit, dhe është investim i Komunës. Pasi që tani ka ndërruar edhe mënyra e investimit, pse nuk ka pasur asnjëherë diskutim publik?

**Mirsad Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Banorët afër rrugës "Bejtë Vitia", në Hajvali, kërkojnë që të bëhet rregullimi i kanalizimit të ujërave të zeza, gjë për të cilën ju është premtuar në vazhdimësi edhe nga nënkyetari i parë i Komunës, edhe nga drejtori, që ka qenë në terren dhe e ka parë gjendjen faktike. Ato ujëra vazhdojnë të rrjedhin në ambiente të hapura pranë shtëpive.
- Banorët afër rrugës "Brigada 153", në Hajvali, kërkojnë vendosjen e pengesave, apo "policëve të shtrirë", në mënyrë që makinat të zvogëlojnë shpejtësinë.

**Suzan Kika, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Banoret e lagjes "Emshiri" pyesin se nëse kanë vendosur me lëshuar këtë linjë të autobusëve "7 C", a kanë menduar për banorët, a duhet pas një stacion ku duhet pritur autobusin, sepse edhe trotuarin nuk e kanë të rregulluar.

Si dëshmi këta banorë i kanë dërguar edhe fotografitë përkatëse për kërkesën në fjalë.

#### Egzon Azemi, për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit:

- Ilmi Reçica, ish-drejtor i gjimnazit "Ahmet Gashi", i shkarkuar nga detyra, me arsyetimin se kinse ai nuk ka treguar performancë të mirë. Prej ditës së shkarkimit e deri më sot ka kërkuar një dokument me një arsyetim, i çfarëdo lloji, rrëth performacës se tij, të cilin ende nuk e ka siguruar, dhe konsideroj që një veprim i tillë është tepër i dëmshëm.
- Kërkesë e Këshillit të prindërve dhe të nxënësve, që ta dinë cili është afati se kur do të vlerësohen dëmet eventuale të objektit të gjimnazit "Ahmet Gashi", sepse fëmijët e këtij gjimnazi po i zhvillojnë mësimet në rrëthana tepër të dëmshme, për shkak se një ndarje e tillë çfarë e kanë një pjesë në gjimnazin "Sami Frashëri", një pjesë në shkollën fillore "Emin Duraku", po krijon vështirësi edhe për profesorët.

**Shpresa Shala**, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, tha se Drejtoria e Arsimit e ka angazhuar një ekip të jashtëm të ekspertëve, të cilët e kanë bërë vlerësimin e performacës të së paku 15 drejtorëve dhe zv. drejtorëve. Edhe drejtori i gjimnazit "Ahmet Gashi", së bashku me Këshillin drejtues të shkollës, me Këshillin e prindërve dhe me Këshillin e nxënësve, i kam pranuar në zyrë, dhe për të gjitha këto detaje ata janë të informuar. Drejtori e ka raportin prej 18 faqeve, i cili duhet të vijë ta marrë fizikisht, sepse duhet ta marr në mënyrë të protokolluar.

#### Agim Gashi, për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit:

- Komuna e ka ndarë një shumë buxhetore për renovimin e objektit të gjimnazit "Ahmet Gashi", andaj pyes se a është tenderuar, për shkak se buxheti ende nuk është miratuar në nivel qendror dhe kemi varësi në nivele komunale, por së paku përgatitjet teknike për shpalljen e tenderit për renovimin e objektit kanë mundur të bëhen.  
Ai objekt nuk rrënohet, është pjesë e trashëgimisë identitare të Prishtinës dhe teknikisht është në rregull, këtë e kanë thënë inxhinierët që punojnë në Komunë.
- Kërkoi të dijë arsyen se pse disa zv. drejtor të shkollave janë ushtrues detyre, përkundër asaj që e kanë plotësuar moshën për pension. Pse të mbahet me muaj e vite me këtë status udhëheqësi i institucionit edukativo arsimor, për shkak se prodhon efekte negative.

**Shpresa Shala**, drejtoreshë, tha se Ministria e Arsimit e ka nxjerrë një udhëzim administrativ për zgjedhjen e drejtorëve, i cili aktualisht është i pazbatueshëm. Nuk është problem vetëm në Komunën e Prishtinës, por është problem në nivel të Kosovës, që nuk po mundemi me shpallur konkurs, për shkak se brenda atij udhëzimi administrativ ka shkelje ligjore.

Kolegjumi i drejtorëve ka kërkuar nga Ministria e Arsimit anulimin e atij udhëzimi administrativ, ose rishikimin e tij, për shkak se e pamundëson zgjedhjen e drejtorëve, është një procedurë e cila brenda procedurës ka shkelje të ligjit. Në fakt, udhëzimi administrativ vetëm duhet me ndihmuar zbatimin e ligjit, kjo është arsyaja pse nuk po mundemi me hapur konkurse për momentin.

Sa i përket objektit të gjimnazit "Ahmet Gashi", tha se tash është duke e vlerësuar një komision i pavarur dhe ata janë në proces të vlerësimit. Ne jemi duke e pritur reportin e tij. Në momentin që del reporti, mbi bazën e atij reporti kemi me vepruar, nëse vendoset për renovim total, atëherë do të shkojmë me renovim total.

**Leonora Shabani - Bajraktari për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit:**

- Pse nuk është shpallur konkursi për asistentë përfshirë fëmijët me nevoja te veçanta?
- Pse ende po vazhdon ai mos interesim, apo çka është ne pyetje, që ka vazhduar ky mosinteresim përfshirë punësimin e asistentëve?

**Shpresa Shala**, drejtoreshë, tha se kur është vendos buxheti prej Ministrisë se Arsimit për asistent, është vendos gabimi i cili në Sektorin e administratës, përfshirë atë arsyet që kanë mundur me u punësuar. Gjatë këtij viti, në momentin që vendoset buxheti në rregull, atëherë shpallet konkursi përfshirë 24 asistentë.

**Valbona Makolli**, drejtoreshë, tha se sa i përket propozimit përfshirë financiare nënave lehone dhe fëmijëve të porsalindur, e që mbeti përfshirë diskutim në njëren nga mbledhjet e radhës, nga ekzekutivi ende nuk është caktuar se kush do të merret me atë grup punues. Andaj kërkoi që shefat e grupeve parlamentare, ose propozuesit e asaj pike, me qenë prezent kur të diskutohet përfshirë caktimin e pikave të cilat parashihen përfshirë në buxhet.

Mbledhja përfundoi në orën 13:25.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

